



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---


Nr. 01/129  
Datë: 27.01.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 27 janar 2017, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohen ekstraktet e procesverbaleve dhe transkripteve nga mbledhjet 122, 123 dhe 124 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 02/129  
Datë: 27.01.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 27 janar 2017, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**Për Koordinimin e Aktit të Biznesit të Vogël (SBA) për Evropën**

1. Duke e njohur rëndësinë e krijimit të një mjedisi të përshtatshëm afarist në Kosovë, i cili e favorizon zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe i cili bazohet në parimet e tregut të lirë, Qeveria e Republikës së Kosovës do të ndërmarrë një sërë reformash të cilat janë të nevojshme për përmirësimin e mjedisit afarist dhe për përmirësimin e pozitës së Kosovës në kuadër të Aktit për Biznes të Vogël (SBA) për Evropën.
2. Duke e marrë parasysh faktin se të gjitha përpjekjet për përmirësimin e mjedisit afarist kërkojnë një qasje gjithëpërfshirëse dhe koordinim ndër sektorial për arritjen e rezultateve të qëndrueshme dhe domethënëse, Qeveria e Republikës së Kosovës cakton organet qeveritare më poshtë si organet kryesore përgjegjëse dhe pika të kontaktit për secilin prej parimeve të Aktit për Biznes të Vogël (SBA) për Evropën:
  - A. Koordinator kombëtar për SBA - Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve (KIESA);
  - B. Nën koordinator kombëtar për SBA - Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve (KIESA);
1. Mësimi i ndërmarrësisë dhe ndërmarrësia e grave, Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë;
2. Falimentimi dhe shansi i dytë për NVM-të - Ministria e Tregtisë dhe Industrisë;
3. Korniza rregullative për politikbërje për NVM-të - Zyra e Kryeministrit;
4. Mjedisi operacional për NVM-të - Ministria e Administratës Publike;
- 5a. Shërbimet mbështetëse për NVM dhe start-up-et - Ministria e Tregtisë dhe Industrisë;
- 5b. KRPP;
6. Qasja në financa për NVM-të - Ministria e Financave;
7. Standardet dhe rregullat teknike - Ministria e Tregtisë dhe Industrisë;
- 8a. Aftësitë për ndërmarrësi - Ministria e Tregtisë dhe Industrisë;
- 8b. Politika e inovacionit për NVM-të - Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë;
9. NVM-të në një ekonomi të gjelbër - Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor;
10. Ndërkombëtarizimi i NVM-ve - Ministria e Tregtisë dhe Industrisë.

3. Secili nga institucionet e radhitura në paragrafin 2. do të themelojnë grupe punuese të cilat do të mbikëqyrren nga Ministri përkatës, si dhe do të përfshijnë akterë të fushës së caktuar, në mënyrë që të përgatisin rekomandime konkrete për përmirësim të mëtutjeshëm në parimet e Aktit për Biznes të Vogël (SBA) për Evropën.
4. Rekomandimet konkrete, të hartuara nën mbikëqyrjen e secilit institucion përgjegjës, duhet të paraqiten në formë të memorandumeve shpjeguese të cilat përcaktojnë ndërhyrjet e nevojshme legislative, rregullative apo operationale që duhet të ndërmerren për përmirësimin e notimit të Kosovës në parimin përkatës të Aktit për Biznes të Vogël (SBA) për Evropën.
5. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, përkatësisht Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve KIESA, caktohet si koordinatorë kombëtare e këtij procesi dhe do t'i koordinojë aktivitetet me institucionet tjera të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi, si dhe do të ofrojë mbështetje metodologjike sipas nevojës.
6. Brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas miratimit të këtij vendimi, Koordinator kombëtar për SBA do t'i dërgojë udhëheqësve të institucioneve përgjegjëse një përmbledhje të secilit parim të SBA dhe dimension të Indeksit të Politikave për NVM-të nga OECD, matjet që bëhen nga këto dimensione si dhe rekomandimet e dala nga analiza e fundit e OECD-së "Indeksi i Politikave për NVM-të: Ballkani Perëndimor dhe Turqia 2016, Vlerësimi i Zbatimit të SBA për Evropën".
7. Secili institucion përgjegjës do të përfundojë analizën dhe memorandumet shpjeguese për parimet dhe dimensionet që i janë caktuar asaj brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve kalendarike pas miratimit të këtij vendimi. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë do të përgatisë një përmbledhje të memorandumeve shpjeguese. Përmbledhja do të prezantohet para Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik nga Koordinator kombëtar për SBA brenda shtatëdhjetë e pesë (75) ditëve kalendarike pas miratimit të këtij vendimi.
8. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 03/129  
Datë: 27.01.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në përputhje me nenin 6.3 dhe 14.3 të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, të nenit 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, duke u bazuar në nenin 8.4.1. të Rregullores për Organizimin dhe Funksonimin e Brendshëm dhe Sistemimin e Vendeve të Punës të Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës dhe me propozimin e Ministrit të Infrastrukturës, në mbledhjen e mbajtur më 27 janar 2017, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Z. Xhelil BEKTESHI emërohet Zëvendës drejtor i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës.
2. Zëvendës drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës emërohet për një mandat 5 (pesë) vjeçar dhe mund të riemërohet nga Qeveria edhe për mandate të tjera pasuese me kohëzgjatje të njëjtë.
3. Detyrat dhe përgjegjësitë e Zëvendës drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës janë të përcaktuara në Rregulloren për Organizimin dhe Funksonimin e Brendshëm dhe Sistemimin e Vendeve të Punës të Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës.
4. Obligohet Ministria e Infrastrukturës, Ministria e Administratës Publike dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---


Nr. 04/129  
Datë: 27.01.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të paragrafit 2. të nenit 9 të Ligjit nr. 05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 27 janar 2017, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohen ndryshimet në Tabelat 3.1, 3.2 dhe 4.2 të Ligjit nr. 05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017, për përmbushjen e obligimeve të pakryera financiare nga viti paraprak për projekte kapitale shumëvjeçare në bazë të paragrafit 2. të nenit 9 të këtij Ligji.
2. Obligohen Institucionet e ndikuara dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimin së bashku me tabelat nga pika 1. e këtij vendimi obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit t'ia procedojë Kuvendit të Republikës së Kosovës për informim.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 05/129  
Datë: 27.01.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 27 janar 2017, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Raporti vjetor financiar (me të dhëna preliminare) për ekzekutimin e buxhetit dhe bilancin e fondeve për vitin 2016.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Raportin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë Kuvendit të Republikës së Kosovës për informim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 06/129  
Datë: 27.01.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 27 janar 2017, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Programi për Reforma në Ekonomi 2017.
2. Obligohet Ministria e Financave që dokumentin nga pika 1. e këtij vendimi ta dorëzojë tek Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Kosovë.
3. Programin për Reforma në Ekonomi nga pika 1. e këtij vendimi obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që t'ia procedojë Kuvendit të Republikës së Kosovës për informim.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---


Nr. 07/129  
Datë: 27.01.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 29 të Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra dhe të nenit 15 të Ligjit nr. 05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 27 janar 2017, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Autorizohet Ministri i Financave që të aprovoj transferet nga nën-programi "Shpenzimet e paparashikuara" në ndonjë nën-program tjetër në Tabelën 3.1 dhe 4.1 për shumat individuale të kërkuara deri në vlerën prej 40,000 euro (dyzetë mijë euro) për vitin 2017 të ndarjeve buxhetore.
2. Shuma e totalit të këtij autorizimi nuk mundë të kaloj 20 % (njëzetë përqind) të shumës së ndarë vjetore të nën-programit "Shpenzimet e paparashikuara".
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 08/129  
Datë: 27.01.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, duke shqyrtuar lëndën “Kërkesë për mbështetje të pjesëmarrjes së studentëve të Universitetit të Prishtinës në Harvard National Model United Nations 2017 ” me nr. protokolli 051 të datës 12.01.2017, në mbledhjen e mbajtur më 27 janar 2017, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Ndahen mjete financiare në vlerë 6.800 (gjashtëmijetëqind euro) për delegacionin e Universitetit të Prishtinës për pjesëmarrje në konferencën e organizuar nga Universiteti Harvard në SHBA.
2. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga Shpenzimet e Paparashikuara, nën-programi Shpenzimet e Paparashikuara me kod 13100, nën kategoria ekonomike e rezervës me kod 38010 dhe transferohen në Universitetin e Prishtinës, nën-programi Universiteti i Prishtinës me kod 90400, kategoria mallra dhe shërbime, nën kategoria ekonomike akomodimi me kod 13660.
3. Obligohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---


Nr. 09/129  
Datë: 27.01.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 27 janar 2017, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Informata e prezantuar nga Zëvendësministria e Ministrisë së Integritimit Evropian, lidhur me takimin e Nën Komitetit të MSA-së për Tregun e Brendshëm, Konkurrencën, Mbrojtjen e Konsumatorit dhe Shëndetit Publik.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë